

Procesverbal- Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

Objekti i procedurës: “Materiale për sinjalistikën vertikale dhe horizontale të rrugëve”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): 34992300-0, 34992200-9.

Vlera e fondit limit: 21 216 549 (njëzetënjë milion e dyqindëgjastëmbëdhjetëmijë e pesëqindëdyzetënjëntë) Lekë pa TVSH ose 221 953.64 (dyqindënjëzetënjë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë.64) Euro pa TVSH.

(Vlera në Euro është konvertuar referuar Kursit zyrtar të këmbimit zyrtar (95.59), datë 20/04/2026).

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenin 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale të vlefshme për realizimin e objektit të kontratës, e lëshuar nga organi kompetent përkatës për kategorinë: N.S – 6/A (Sinjalistika rrugore jondriçuese)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) *përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”, nenin 40, pika 5, gërma (a), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekti i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore”.

Në bazë të licencës profesionale të shoqërisë tregohet aftësia teknike e profesionale e realizimit të kontratës që prokurohet dhe pikat e kërkuara të licensës janë përcaktuar nga vlera e punimeve që do të realizohen si dhe nisur nga natyra e punëve që do të kryhen sipas zërave të preventivit. Nisur nga fakti që vlera e objektit është më e vogël se 20 milion lekë për kategoritë e punimeve, është zgjedhur niveli i klasifikimit ”A” që i përgjigjet kësaj vlere.

Kërkesa që operatori ekonomik të jetë i pajisur me licencë profesionale të vlefshme për realizimin e objektit të kontratës, e lëshuar nga organi kompetent përkatës për kategorinë: N.S – 6/A (Sinjalistika rrugore jondriçuese), është e nevojshme për vijëzimin e shiritave gjatësorë dhe anësorë me gjerësi 15 cm (termoplastik, spray) dhe vijëzimet e kalimit të këmbësorëve (bikomponente, paste). Vijëzimet kërkojnë njohuri të specializuara për aplikimin e materialeve të sinjalistikës në rrugë dhe respektimin e standardeve të sigurisë dhe qëndrueshmërisë. Operatorët e licencuar në kategorinë N.S – 6/A kanë aftësitë dhe ekspertizën për të zgjedhur, materialet e duhura, për të aplikuar teknikat e rekomanduara dhe për të garantuar rezultate që përmbushin specifikimet teknike dhe ligjore.rrugore dhe ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë rrugore. Prandaj, kërkesa për licencë profesionale është proporcionale, e nevojshme dhe siguron që vetëm operatorët me eksperiencë të kryejnë këto punime.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/a dhe nenin 47 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar,

ku përcaktohet se “*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar*”. Në rastin konkret, nga ana e Njësisë së Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a, AK nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së lotit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontratës për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit*”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “*.....Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji*”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar dhe nenit 14 të Ligjit Nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar.

Ky kriter, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën sa 35 % e vlerës së fondit limit të lotit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku parashikohet se “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën” nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 35 % të vlerës së fondit limit.

Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke qënë se vlera e fondit limit është mbi kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur.

Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me certifikata të vlefshme të lëshuara nga organizma të akredituar, si më poshtë:

- *SSH/EN ISO 9001:2015 – Sistemi i menaxhimit të cilësisë/ose ekuivalent;*
- *SSH/EN ISO 14001:2015 – Sistemi i menaxhimit mjedisor/ose ekuivalent;*
- *SSH/EN ISO 45001:2018 – Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë/ose ekuivalent;*

- *SSH/EN ISO 39001:2012 – Sistemi i menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor/ose ekuivalent,*
në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Kjo kërkesë është në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nganjë organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

ISO 9001:2015 – Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë: Kjo certifikatë siguron që operatori ekonomik ka të implementuara procedura të standardizuara për kontrollin e cilësisë në të gjitha fazat e aktivitetit, duke përfshirë projektimin, prodhimin, furnizimin dhe instalimin e sinjalistikës rrugore. Në një sektor ku gabimet apo devijimet nga standardet mund të sjellin pasoja të rënda, një sistem i menaxhimit të cilësisë është i domosdoshëm për të garantuar përputhshmëri me specifikimet teknike dhe jetëgjatësi të produkteve të instaluar.

ISO 14001:2015 – Sistemi i Menaxhimit Mjedisor: Sinjalistika rrugore përfshin përdorimin e materialeve si bojëra, solventë, materiale reflektuese dhe struktura metalike, të cilat mund të kenë ndikim në mjedis. Kjo certifikatë garanton që operatori ekonomik identifikon, monitoron dhe minimizon ndikimet mjedisore të aktivitetit të tij, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe praktikën më të mira ndërkombëtare. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në projekte infrastrukturore që zhvillohen në hapësira publike.

ISO 45001:2018 – Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë: Zbatimi i sinjalistikës rrugore shpesh kryhet në kushte pune me rrezik të shtuar, si në rrugë me trafik aktiv, në kushte atmosferike të ndryshme apo në orare të zgjatura pune. Kjo certifikatë garanton që operatori ekonomik ka politika dhe procedura efektive për identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve në punë, duke mbrojtur punonjësit, përdoruesit e rrugës dhe palët e treta.

ISO 39001:2012 – Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë në Trafikun Rrugor: Kjo certifikatë është veçanërisht e rëndësishme për objektin konkret të prokurimit, pasi lidhet drejtpërdrejt me përmirësimin e sigurisë rrugore dhe reduktimin e aksidenteve. Operatorët ekonomikë të certifikuar sipas këtij standardi kanë të implementuara praktika dhe procedura që synojnë minimizimin e rreziqeve në trafik, duke përfshirë planifikimin e duhur të ndërhyrjeve në rrugë, vendosjen korrekte të sinjalistikës dhe respektimin e standardeve të sigurisë rrugore.

Kërkesa që certifikatat të jenë të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë të njohur nga Republika e Shqipërisë, garanton vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre. Kjo shmang paraqitjen e certifikatave jo të besueshme dhe siguron që operatorët janë audituar nga trupa të pavarura dhe kompetente.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, ose kontratë furnizimi për mallrat sipas preventivit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota identifikuese të prodhuesit (telefon, fax, e-mail, faqe interneti). Në rastet kur autorizimi paraqitet nga distributori, duhet të vërtetohet lidhja ndërmjet prodhuesit dhe distributorit të autorizuar.

Argumentimi: Ky kriter gjen mbështetje në pikat 2 dhe 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 5 të nenit 44 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku është e cituar: 5. *Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Kriteri që kërkon paraqitjen e një autorizimi nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, ose një kontrate furnizimi për mallrat sipas preventivit, është i justifikuar plotësisht nga natyra e objektit të prokurimit, i cili lidhet me furnizimin e materialeve për sinjalistikën rrugore, një komponent thelbësor për garantimin e sigurisë publike dhe funksionimin normal të trafikut.

Sinjalistika rrugore, si horizontale ashtu edhe vertikale, përbëhet nga produkte specifike teknike, si tabela reflektuese, folie prizmatike, bojëra speciale për vijëzim dhe elementë të tjerë sigurie, të cilët duhet të përmbushin standarde të përcaktuara kombëtare dhe europiane. Për këtë arsye, është e domosdoshme që autoriteti kontraktor të sigurohet që operatori ekonomik ka akses të drejtpërdrejtë dhe të garantuar në burime furnizimi të ligjshme dhe të besueshme, në mënyrë që të shmanget furnizimi me produkte jo origjinale, jashtë standardit ose me cilësi të ulët.

Kërkesa për autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar garanton që operatori ekonomik është i lidhur zyrtarisht me zinxhirin e furnizimit dhe ka të drejtë të tregtojë dhe furnizojë produktet përkatëse. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për materiale si fletët reflektuese, bojërat rrugore dhe komponentët e sinjalistikës, të cilat duhet të jenë të certifikuar dhe të gjurmueshme në origjinë, në mënyrë që të përmbushin kërkesat teknike të përcaktuara në specifikime.

Alternativa e paraqitjes së një kontrate furnizimi është parashikuar për të mos kufizuar konkurrencën, duke u dhënë mundësi operatorëve ekonomikë që nuk janë distributorë të drejtpërdrejtë të provojnë se kanë siguruar burimin e furnizimit për mallrat objekt prokurimi. Në këtë mënyrë respektohet parimi i proporcionalitetit dhe i mosdiskriminimit, ndërkohë që ruhet garancia për realizimin e kontratës.

Kërkesa që autorizimi të përmbajë të dhëna të plota identifikuese të prodhuesit, si numri i telefonit, adresa e postës elektronike dhe faqja zyrtare e internetit, është e nevojshme për të mundësuar verifikimin e autenticitetit të dokumentit dhe të vetë prodhuesit. Kjo shmang paraqitjen e dokumenteve të pasakta ose të pavlefshme dhe rrit transparencën e procedurës së prokurimit.

Në rastet kur autorizimi paraqitet nga një distributor, kërkesa për të provuar lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit të autorizuar është thelbësore për të garantuar që ky i fundit vepron në mënyrë legjitime dhe jo si një ndërmjetës i paautorizuar. Kjo siguron vazhdimësinë dhe sigurinë e zinxhirit të furnizimit, si dhe cilësinë e produkteve të ofruara.

Në kontekstin e sinjalistikës rrugore, mungesa e një garancie të tillë mbi origjinën dhe furnizimin e materialeve mund të sjellë pasoja të drejtpërdrejta në sigurinë rrugore, pasi përdorimi i materialeve jo cilësore apo jo të certifikuara ndikon në dukshmërinë, qëndrueshmërinë dhe funksionalitetin e sinjalistikës, duke rritur rrezikun për aksidente dhe duke shkaktuar kosto shtesë për mirëmbajtje.

Në përfundim, ky kriter është i arsyeshëm, proporcional dhe i lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, pasi synon të garantojë që operatorët ekonomikë kanë kapacitet real për furnizimin e materialeve cilësore dhe të certifikuara për sinjalistikën rrugore, duke mbrojtur interesin publik dhe duke siguruar realizimin e suksesshëm të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë ose fragmente katalogësh të prodhuesit, si dhe/ose skeda teknike për listën e mallrave objekt prokurimi, në të cilat të pasqyrohen qartë materialet që do të ofrohen, të identifikuara me emërtimin dhe/ose markën përkatëse.

Në këto dokumente duhet të paraqiten në mënyrë të plotë dhe të qartë të gjitha karakteristikat teknike të produkteve, me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përputhshmërinë e tyre me specifikimet teknike të kërkuara.

Argumentimi: Ky kriter është bazuar në nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, si dhe pikën 6/b të nenit 40 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është përcaktuar se: [...] 6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: [...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].*

Paraqitja e katalogjeve për të gjithë artikujt që janë objekt prokurimi është kërkuar me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së mallrave që operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Kriteri që kërkon paraqitjen e katalogëve, fragmenteve të katalogëve të prodhuesit dhe/ose skedave teknike për mallrat objekt prokurimi është plotësisht i justifikuar nga natyra e kontratës, e cila lidhet me furnizimin e materialeve për sinjalistikën rrugore, një sektor ku cilësia dhe përputhshmëria teknike e produkteve kanë ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë publike dhe funksionimin e trafikut.

Materialet e sinjalistikës rrugore, si tabelat vertikale, fletët reflektuese, bojërat për vijëzim, përvijuesit dhe elementët mbajtës, janë produkte me specifika të detajuara teknike dhe me kërkesa të qarta për performancë, të përcaktuara në standarde kombëtare dhe europiane. Për këtë arsye, është e domosdoshme që autoriteti kontraktor të ketë mundësi të verifikojë në mënyrë objektive dhe të dokumentuar që produktet e ofruara nga operatorët ekonomikë përmbushin këto kërkesa, përpara lidhjes së kontratës.

Paraqitja e katalogëve ose skedave teknike të prodhuesit siguron një burim zyrtar dhe të besueshëm informacioni mbi produktin, ku pasqyrohen karakteristikat reale të tij, si përbërja, parametrat fizikë dhe mekanikë, performanca reflektuese, qëndrueshmëria ndaj kushteve atmosferike, jetëgjatësia dhe përputhshmëria me standardet përkatëse. Në mungesë të këtij dokumentacioni, autoriteti

kontraktor nuk do të kishte mundësi të vlerësonte nëse produktet e ofertës janë në përputhje me specifikimet teknike, duke rritur rrezikun e pranimit të materialeve jo cilësore ose jashtë standardit. Kërkesa që materialet të identifikohen qartë me emërtimin dhe/ose markën përkatëse është thelbësore për të siguruar gjurmueshmërinë e produkteve dhe për të shmangur paqartësitë apo zëvendësimet gjatë fazës së zbatimit të kontratës. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për produkte si fletët reflektuese apo bojërat rrugore, ku performanca teknike ndryshon ndjeshëm në varësi të prodhuesit dhe teknologjisë së përdorur.

Në kontekstin e sinjalistikës rrugore, parametrat teknikë si koeficienti i retroreflektivitetit, rezistenca ndaj konsumit, koha e tharjes, trashësia e aplikimit, rezistenca ndaj rrezeve UV dhe qëndrueshmëria në kushte atmosferike janë elementë kritikë që ndikojnë drejtpërdrejt në dukshmërinë dhe funksionalitetin e sinjalistikës. Këto të dhëna mund të verifikohen vetëm nëpërmjet dokumentacionit teknik të prodhuesit dhe jo mbi bazën e deklarimeve të përgjithshme të operatorit ekonomik.

Ky kriter krijon mundësinë për krahasim të drejtpërdrejtë dhe objektiv ndërmjet ofertave, bazuar në të dhëna të standardizuara dhe të verifikueshme. Njëkohësisht, ai shërben si mekanizëm kontrolli për të parandaluar ofertimin e produkteve që nuk përputhen realisht me specifikimet, por që mund të paraqiten si të tilla në mënyrë deklarative.

Në përfundim, ky kriter është i domosdoshëm për të garantuar që produktet e ofruara janë në përputhje me kërkesat teknike dhe standardet në fuqi, duke siguruar cilësi, qëndrueshmëri dhe siguri në përdorimin e sinjalistikës rrugore. Në mungesë të këtij dokumentacioni, rritet ndjeshëm rreziku për furnizim me produkte jo të përshtatshme, çka do të ndikonte negativisht si në sigurinë rrugore ashtu edhe në përdorimin efikas të fondeve publike.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë stafin teknik si më poshtë:

Një inxhinier ndërtimi, i diplomuar në fushën e Inxhinierisë së Ndërtimit, profili infrastrukturë transporti.

Një inxhinier mekanik me profil në sinjalistikë dhe siguri rrugore.

Tre punonjës për realizimin e vijëzimeve në asfalt, të pajisur me dëshmi ose certifikatë kualifikimi përkatëse.

Dhjetë punëtorë të thjeshtë.

Një punonjës i certifikuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”.

Ky kriter do të përmbushet nga operatori ekonomik nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të paraqesë dokumentacionin provues për stafin teknik, përfshirë diplomat për inxhinierët, dëshmitë/certifikatat e kualifikimit për punonjësit përkatës, kontratat e vlefshme të punës, si dhe listëpagesat e sigurimeve shoqërore, me qëllim vërtetimin e kualifikimit dhe marrëdhënies së punësimit. Ky dokumentacion duhet të dorëzohet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77, pika 4, e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), nenin 40, pika 5/b, c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) ku parashikohet se “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të

përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës, c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;”.

Kërkesa për disponimin e stafit teknik të përcaktuar në kriterin 3.4 është e domosdoshme, e justifikuar dhe drejtpërdrejt e lidhur me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës, e cila ka si objekt furnizimin dhe realizimin e punimeve të sinjalistikës rrugore, përfshirë vijëzimet horizontale në asfalt dhe vendosjen e elementeve të sinjalistikës vertikale. Ky lloj objekti prokurimi nuk përbën thjesht furnizim materiale, por një ndërhyrje me ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë rrugore, orientimin e trafikut dhe mbrojtjen e jetës së përdoruesve të rrugës, ndaj kërkon domosdoshmërisht kapacitete njerëzore të kualifikuara dhe të specializuara.

Përfshirja e një inxhinieri ndërtimi me profil në infrastrukturë transporti është e nevojshme pasi ky profil siguron njohuritë teknike për projektimin, organizimin dhe kontrollin e punimeve në rrugë, përfshirë kuptimin e gjeometrisë rrugore, standardeve të sinjalistikës horizontale dhe vertikale, si dhe mënyrën e integritit të tyre në infrastrukturën ekzistuese. Ky specialist garanton që vijëzimet të realizohen në përputhje me projektin teknik, specifikimet dhe standardet përkatëse, duke minimizuar gabimet në zbatim dhe duke siguruar cilësi të qëndrueshme.

Përfshirja e një inxhinieri mekanik me profil në sinjalistikë dhe siguri rrugore është e justifikuar nga nevoja për të mbuluar aspektet teknike të pajisjeve, materialeve dhe teknologjisë së përdorur në sinjalistikë, veçanërisht për elementë si bojërat termoplastike, sistemet e aplikimit, pajisjet e vijëzimit dhe materialet reflektuese. Ky profil kontribuon gjithashtu në vlerësimin e performancës së materialeve në kushte reale pune dhe në garantimin e standardeve të sigurisë rrugore, duke siguruar që produktet e përdorura të jenë funksionale dhe të qëndrueshme në kohë.

Tre punonjës të specializuar për realizimin e vijëzimeve në asfalt me dëshmi ose certifikatë kualifikimi janë të domosdoshëm për vetë natyrën e punimeve FV, të cilat kërkojnë njohuri praktike dhe teknike në aplikimin e bojërave rrugore, respektimin e temperaturave të punimit, dozimin e materialeve reflektuese dhe zbatimin e trashësisë së kërkuar të shtresës. Këta punonjës sigurojnë që vijëzimet të realizohen sipas standardeve teknike, me dukshmëri optimale dhe jetëgjatësi të mjaftueshme, duke ndikuar drejtpërdrejt në sigurinë e qarkullimit rrugor.

Dhjetë punëtorë të thjeshtë janë të domosdoshëm për realizimin e volumit të punimeve, duke marrë parasysh që sinjalistika rrugore përfshin aktivitete në terren, si përgatitja e sipërfaqes, vendosja e tabelave, asistenca gjatë aplikimit të vijëzimeve dhe sigurimi i zonës së punimeve. Ky numër është i arsyeshëm në raport me natyrën e punimeve dhe garanton që kontrata të realizohet brenda afateve të përcaktuara, pa cenuar cilësinë dhe sigurinë në punë.

Përfshirja e një punonjësi të certifikuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” është një kërkesë thelbësore, duke qenë se punimet në sinjalistikë zhvillohen shpesh në rrugë aktive, me trafik të hapur dhe me rreziqe të larta për punonjësit dhe përdoruesit e rrugës. Ky specialist garanton zbatimin e masave të sigurisë në përputhje me legjislacionin në fuqi për shëndetin dhe sigurinë në punë, organizimin e punimeve në mënyrë të sigurt dhe minimizimin e rreziqeve aksidentale gjatë zbatimit të kontratës.

Kërkesa që përmbushja e këtij kriteri të bëhet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit është në përputhje me parimet e thjeshtimit të procedurave dhe lehtësimit të pjesëmarrjes në prokurim, ndërsa kërkesa për paraqitjen e dokumentacionit provues nga operatori ekonomik i renditur i pari siguron verifikimin real të kapaciteteve përpara lidhjes së kontratës. Dokumentacioni si diplomat, certifikatat e kualifikimit, kontratat e punës dhe listëpagesat e sigurimeve shoqërore garanton që stafi i deklaruar është realisht i punësuar dhe i disponueshëm

për realizimin e kontratës, duke shmangur deklaratimet fiktive dhe duke rritur besueshmërinë e procedurës.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet teknike si më poshtë:

- *Një makineri për aplikimin e bojës termoplastike (APV);*
- *Një makineri vijëzimi vetëlëvizëse me bojë bikomponente (paste);*
- *Një kamionçinë me kapacitet mbajtës jo më pak se 1.5 ton;*
- *Një kompresor i lëvizshëm;*
- *Një gjenerator;*
- *Dy sete semaforësh për kontrollin e trafikut;*
- *Një mjet për pastrimin e vijëzimeve/bojës ekzistuese;*
- *Një mjet transporti ATV – karrotrec me kapacitet mbajtës 2–2.5 ton.*

Për mjetet dhe pajisjet e sipërcituara, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

Për mjetet që regjistrohen në regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i vlefshëm i mjetit, si dhe taksat vjetore, si dhe leja e transportit të mallrave brenda vendit për ato mjete për të cilat kërkohet pajisja me leje transporti sipas legjislacionit në fuqi.

Për mjetet e marra me qira, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i vlefshëm i mjetit, si dhe leja e transportit të mallrave brenda vendit për ato mjete për të cilat kërkohet pajisja me leje transporti sipas legjislacionit në fuqi. Mjetet duhet të shoqërohen me kontratë qiraje të vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera, duhet të paraqiten aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

Për mjetet dhe pajisjet që nuk regjistrohen në regjistrat publikë, duhet të paraqiten dokumentet që vërtetojnë pronësinë e tyre.

Për pajisjet teknike, kur janë në pronësi, duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes ose kontratat e shitblerjes. Kur janë me qira, duhet të paraqiten kontratat noteriale të qirasë, si dhe faturat tatimore të shitjes ose kontratat e shitblerjes, sipas rastit. Faturat që nuk janë sipas formatit të miratuar me TVSH (faturat e biznesit të vogël) duhet të shoqërohen me kuponin tatimor.

Ky kriter do të përmbushet nga operatori ekonomik nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e automjeteve dhe makinerive, duhet të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77, pika 1/c, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 40, pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), ku parashikohet se “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”.

Ky lloj aktiviteti kërkon pajisje të specializuara, teknologji të dedikuara dhe kapacitet operativ në terren, pasi sinjalistika rrugore ndikon drejtpërdrejt në sigurinë e qarkullimit dhe në orientimin e

përdoruesve të rrugës. Për këtë arsye, çdo mjet i kërkuar ka funksion të veçantë teknik dhe është i pazëvendësueshëm në procesin e realizimit të kontratës.

Makineria për aplikimin e bojës termoplastike (APV) është thelbësore për realizimin e vijëzimeve rrugore me teknologji termoplastike, e cila kërkon ngrohje të materialit në temperatura të kontrolluara dhe aplikim të njëtrajtshëm mbi sipërfaqen e asfaltit. Kjo pajisje siguron trashësi të qëndrueshme të shtresës, shpërndarje uniforme të materialit dhe integrim të mikrosferave reflektuese, duke garantuar dukshmëri të lartë natën dhe rezistencë ndaj konsumit mekanik nga trafiku. Pa këtë pajisje, nuk mund të arrihet cilësia e kërkuar sipas standardeve për sinjalistikën horizontale.

Makineria vetëlëvizëse për vijëzime me bojë bikomponente (paste) është e domosdoshme për realizimin e vijëzimeve me performancë të lartë, të cilat përdoren në zona me ngarkesë të madhe trafiku si kalimet e këmbësorëve dhe segmentet urbane. Kjo pajisje siguron përzierjen automatike të komponentëve, dozimin e saktë të materialit dhe aplikimin me trashësi të kontrolluar, duke garantuar rezistencë të lartë ndaj konsumit dhe jetëgjatësi të sinjalistikës. Gjithashtu mundëson realizimin e klasave të larta të performancës sipas standardeve EN për reflektim dhe qëndrueshmëri.

Kamionçina me kapacitet jo më pak se 1.5ton është e nevojshme për transportin e materialeve, pajisjeve dhe personelit në kantieret e punës, të cilat shpesh janë të shpërndara në distanca të ndryshme gjeografike. Ky mjet garanton logjistikë efikase, furnizim në kohë me materiale dhe fleksibilitet në organizimin e punimeve në terren, duke shmangur vonesat në zbatim dhe duke siguruar vazhdimësinë e procesit të punës.

Kompresori i lëvizshëm është i domosdoshëm për pastrimin paraprak të sipërfaqes së asfaltit përpara aplikimit të vijëzimeve. Ai siguron largimin e pluhurit, papastërtive dhe materialeve të lirshme, duke krijuar kushtet optimale për ngjitjen e bojës ose materialit termoplastik me sipërfaqen e rrugës. Ky proces është kritik për cilësinë e sinjalistikës, pasi çdo ndotje e sipërfaqes ndikon negativisht në aderencën dhe jetëgjatësinë e vijëzimeve.

Gjeneratori është i nevojshëm për furnizimin me energji elektrike në raste kur nuk ka burim të qëndrueshëm energjie në terren. Duke qenë se punimet e sinjalistikës shpesh kryhen në segmente rrugore jashtë zonave urbane, gjeneratori garanton funksionimin e pandërprerë të pajisjeve teknike, duke siguruar vazhdimësinë e punimeve dhe shmangien e ndërprerjeve që ndikojnë në cilësi dhe afate.

Dy sete semaforësh për kontrollin e trafikut janë të domosdoshëm për menaxhimin e qarkullimit gjatë kryerjes së punimeve në rrugë aktive. Këto pajisje mundësojnë organizimin e trafikut në mënyrë të sigurt, reduktojnë rrezikun e aksidenteve dhe sigurojnë mbrojtjen e punonjësve dhe përdoruesve të rrugës. Ato janë pjesë e detyrueshme e masave të sigurisë gjatë ndërhyrjeve në infrastrukturën rrugore.

Mjeti për pastrimin e vijëzimeve ose bojës ekzistuese është i nevojshëm në rastet e rehabilitimit të sinjalistikës ekzistuese, ku kërkohet heqja e vijëzimeve të vjetra përpara aplikimit të reja. Ky proces siguron që sipërfaqja të jetë e pastër dhe e përgatitur teknikiisht, duke shmangur mbivendosjen e materialeve dhe duke garantuar qartësi vizuale të sinjalistikës së re.

Mjeti transporti ATV – karrotrec me kapacitet 2–2.5 ton është i domosdoshëm për transportin e pajisjeve dhe materialeve në zona me akses të vështirë ose në segmente ku mjetet e mëdha nuk mund të operojnë. Ky mjet rrit fleksibilitetin në terren dhe mundëson ndërhyrje më të shpejta dhe më efikase në segmente të ndryshme rrugore.

Në tërësi, të gjitha mjetet dhe pajisjet e kërkuara përbëjnë një sistem të integruar teknik, i cili garanton realizimin e plotë të punimeve të sinjalistikës rrugore sipas standardeve të cilësisë, sigurisë dhe performancës. Ato janë të domosdoshme për sigurimin e vazhdimësisë së punimeve, respektimin e afateve kontraktuale dhe garantimin e sigurisë rrugore gjatë dhe pas realizimit të kontratës.

Kërkesa për dokumentacion provues dhe mënyra e vetëdeklarimit në fazën fillestare është në përputhje me parimet e transparencës dhe konkurrencës në prokurimet publike, ndërsa verifikimi i dokumenteve për operatorin e renditur i pari siguron kontrollin efektiv të kapaciteteve reale përpara lidhjes së kontratës. Kjo procedurë garanton që operatori ekonomik ka në dispozicion realisht mjetet e deklaruar dhe shmang deklaramet fiktive, duke mbrojtur interesin publik dhe duke siguruar zbatimin me sukses të kontratës.

2.3.7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë në datën dhe orën e hapjes së prokurimit, mostër të produkteve si më poshtë:

Përvijues normal anësor (Lavjerës)

Cilindër Fe Pengues Parkimi+strukturë mbajtëse cilësia e III e adezivit

Tabelë tetëkëndore e vogël me A-b 60-20

Tabelë katrore normale me A=60

Tabelë drejtkëndore tregimi AXB e vogël 60x90 parkim publik me pagesë

Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë në datën dhe orën e hapjes së tenderit, me adresë: pranë stadiumit, Himarë.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe pikën 6/a, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;”.

Duke qenë se këto produkte ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë rrugore, orientimin e përdoruesve të rrugës dhe organizimin e qarkullimit, vlerësimi i tyre nuk mund të mbështetet vetëm në

dokumentacion teknik, por kërkon domosdoshmërisht verifikim fizik të cilësisë, materialit, përpunimit dhe standardit të prodhimit.

Paraqitja e mostrave i jep autoritetit kontraktor mundësinë të verifikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë përputhshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, duke shmangur rrezikun e ofertimit formal të produkteve që në praktikë mund të jenë me cilësi më të ulët, me materiale të ndryshme ose me përfundim jo sipas standardeve të kërkuara. Ky kriter është veçanërisht i rëndësishëm për sinjalistikën rrugore, ku qëndrueshmëria, reflektimi, rezistenca ndaj korrozionit dhe cilësia e përpunimit kanë ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë publike.

Mostra e përvijuesit normal anësor (lavjerrës) është e nevojshme për të vlerësuar cilësinë e materialit plastik, elasticitetin, mekanizmin e rikthimit në pozicionin vertikal dhe qëndrueshmërinë e elementëve reflektues. Ky element përdoret në zona të ndjeshme të trafikut për orientim dhe paralajmërim, ndaj duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj goditjeve dhe dukshmëri të mirë gjatë natës. Vlerësimi fizik i mostrës siguron që mekanizmi i sustës dhe lidhjeve strukturore funksionon sipas kërkesave teknike dhe nuk është vetëm i deklaruar në dokumentacion.

Mostra e cilindrit Fe pengues parkimi me strukturë mbajtëse dhe cilësi adezivi të klasës III është e domosdoshme për të verifikuar cilësinë e metalit, procesin e galvanizimit, stabilitetin e strukturës dhe forcën e fiksimit në terren. Ky element përdoret për kontrollin fizik të parkimit dhe mbrojtjen e hapësirave publike, ndaj kërkohet rezistencë e lartë mekanike dhe mbrojtje ndaj korrozionit. Gjithashtu, cilësia e adezivit është kritike për dukshmërinë dhe jetëgjatësinë e elementit reflektues, duke siguruar që ai të mbetet funksional në kushte atmosferike të ndryshme.

Mostra e tabelës tetëkëndore të vogël me përmasë A-B 60-20 shërben për verifikimin e përputhshmërisë me standardet e sinjalistikës rrugore për shenjën “STOP”, e cila është një nga sinjalet më kritike për sigurinë rrugore. Vlerësohet forma, dimensionimi, cilësia e fletës reflektuese, ngjyrat standarde dhe përfundimi i prodhimit, pasi çdo devijim në këto parametra mund të ndikojë në mosnjohjen e sinjalit nga drejtuesit e mjeteve dhe të rrisë rrezikun e aksidenteve.

Mostra e tabelës katrore normale me A=60 ka funksion verifikimin e sinjaleve informuese dhe rregulluese, të cilat përdoren gjerësisht në rrjetin rrugor urban dhe interurban. Kjo mostër lejon autoritetin kontraktor të vlerësojë cilësinë e printimit, reflektimin, rezistencën ndaj kushteve atmosferike dhe saktësinë e ngjyrave sipas standardeve përkatëse. Uniformiteti dhe qartësia vizuale janë elementë thelbësorë për efektivitetin e kësaj sinjalistike.

Mostra e tabelës drejtkëndore të tregimit me përmasë 60x90 për parkim publik me pagesë është e rëndësishme për të verifikuar sinjalistikën informuese urbane, e cila ka ndikim të drejtpërdrejtë në menaxhimin e hapësirave publike dhe organizimin e parkimit. Ky element duhet të ketë lexueshmëri të lartë, kontrast të mirë ngjyrash dhe material reflektues cilësor, në mënyrë që të jetë i dukshëm në çdo kusht ndriçimi. Mostra fizike siguron që dizajni, fontit dhe materialet janë në përputhje me standardet dhe nuk paraqesin devijime nga specifikimet.

Në tërësi, paraqitja e mostrave përbën një mekanizëm të domosdoshëm kontrolli cilësor ex-ante, i cili i mundëson autoritetit kontraktor të verifikojë në mënyrë praktike përputhshmërinë e produkteve me specifikimet teknike përpara shpalljes së fituesit. Duke qenë se sinjalistika rrugore ndikon drejtpërdrejt në sigurinë publike, ky kriter garanton që produktet e ofruara nuk janë vetëm të përshkruara teknikisht, por realisht përmbushin standardet e kërkuara në aspektin e materialit, qëndrueshmërisë, reflektimit dhe funksionalitetit në terren.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike të përcaktuara për këtë procedurë prokurimi, e cila ka si objekt furnizimin me materiale për sinjalistikën rrugore dhe realizimin e vijëzimeve (FV), janë hartuar në mënyrë të detajuar dhe në përputhje të plotë me natyrën e kontratës dhe rëndësinë që ka sinjalistika në garantimin e sigurisë rrugore. Këto kërkesa mbështeten në standardet shqiptare dhe europiane në fuqi, si dhe në Manualin Teknik të Çmimeve të miratuar me VKM Nr. 216, datë 13.04.2023, duke synuar sigurimin e cilësisë, qëndrueshmërisë dhe performancës afatgjatë të materialeve dhe punimeve.

Në lidhje me sinjalistikën vertikale, kërkesa që prodhuesi të jetë i pajisur me certifikim sipas standardit EN 1090-1 është e domosdoshme për të garantuar që strukturat metalike të tabelave dhe elementët mbajtës përmbushin kërkesat për siguri mekanike dhe rezistencë strukturore. Këto elemente janë të ekspozuara në kushte atmosferike dhe ndaj ngarkesave të jashtme, si era apo goditjet e mundshme, dhe çdo mungesë cilësie mund të krijojë rrezik për përdoruesit e rrugës. Po ashtu, kërkesa për përdorimin e fletëve reflektuese prizmatike me intensitet të lartë, të klasës RA2 sipas standardit EN 12899-1, është plotësisht e justifikuar pasi siguron dukshmëri optimale të sinjaleve gjatë natës dhe në kushte të vështira atmosferike. Teknologjia me mikroprizma të mbyllura garanton reflektim më të lartë dhe më të qëndrueshëm krahasuar me teknologjitë tradicionale, ndërsa parametrat e përcaktuar për koeficientin e reflektimit, kromaticitetin dhe ruajtjen e performancës pas plakjes janë standardë ndërkombëtarë që sigurojnë funksionalitet të qëndrueshëm në kohë.

Kërkesa për jetëgjatësi minimale prej 10 vitesh është e arsyeshme dhe në përputhje me praktikat më të mira, pasi shmang nevojën për zëvendësime të shpeshta dhe ul kostot e mirëmbajtjes për autoritetin kontraktor. Në të njëjtën kohë, përputhshmëria me Rregulloren e Produkteve të Ndërtimit (BE) Nr. 305/2011 dhe standardin EN 12899-1 garanton që materialet janë të certifikuara, të sigurta dhe të pranueshme në tregun evropian, duke shmangur përdorimin e produkteve jashtë standardit.

Sa i përket strukturave mbajtëse, specifikimi për tuba çeliku të galvanizuar me diametër 60 mm dhe trashësi të përcaktuar është i domosdoshëm për të siguruar rezistencë ndaj korrozionit dhe qëndrueshmëri mekanike në kushte të jashtme. Galvanizimi mbron materialin nga degradimi i shpejtë dhe garanton jetëgjatësi më të madhe të elementëve mbajtës, të cilët janë pjesë integrale e funksionimit të sinjalistikës vertikale.

Për elementët e sigurisë si përvijuesit anësorë dhe birilat fleksibël, kërkesat për materiale rezistente ndaj goditjeve, mekanizëm rikthimi elastik dhe përdorim të materialeve plastike cilësore janë të domosdoshme për shkak të ekspozimit të tyre të vazhdueshëm ndaj kontaktit me mjetet. Funksioni i tyre është të orientojnë dhe të paralajmërojnë drejtuesit e mjeteve, ndaj duhet të jenë të dukshëm, të qëndrueshëm dhe të rikthehen në pozicionin fillestar pas goditjes, pa krijuar rrezik shtesë në rrugë.

Në lidhje me vijëzimet rrugore, të cilat përbëjnë pjesën e vetme të realizimit me fond vlerë, specifikimet teknike për bojërat termoplastike dhe bikomponente janë të bazuara në standarde të njohura ndërkombëtare dhe synojnë garantimin e performancës në kushte reale trafiku. Kërkesa për nivel minimal të retroreflektivitetit, përdorimin e mikrosferave të qelqit dhe parametrat e aplikimit janë të domosdoshëm për të siguruar dukshmëri të mirë natën dhe rezistencë ndaj konsumit. Boja termoplastike e aplikuar me temperaturë të kontrolluar dhe me përbërje të përshtatshme garanton qëndrueshmëri ndaj abrazionit dhe jetëgjatësi më të madhe, ndërsa

përdorimi i bojërave bikomponente me klasë trafiku P7 sipas standardeve përkatëse siguron performancë të lartë në zona me ngarkesë të madhe, si kalimet e këmbësorëve.

Kërkesat për testim dhe performancë sipas standardeve si EN 1436 dhe EN 13197 lidhen drejtpërdrejt me verifikimin e sjelljes së materialeve në kushte reale përdorimi dhe nuk përbëjnë kufizim, por garanci që produktet e ofruara janë efektive dhe të sigurta. Po ashtu, përcaktimi i kushteve të aplikimit, përgatitjes së sipërfaqes dhe masave të sigurisë gjatë punimeve është i domosdoshëm për të siguruar cilësinë e zbatimit dhe për të shmangur rreziqet për qarkullimin rrugor gjatë realizimit të kontratës, në përputhje me Kodin Rrugor dhe aktet nënligjore në fuqi.

Këto specifikime teknike janë të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit dhe janë të bazuara në standarde të njohura gjerësisht, duke respektuar parimin e proporcionalitetit. Ato synojnë të garantojnë që materialet dhe punimet e realizuara të jenë cilësore, të qëndrueshme dhe të sigurta, duke mbrojtur interesin publik dhe duke siguruar përdorim efikas të fondeve publike. Në mungesë të këtyre kërkesave, ekziston rreziku i përdorimit të materialeve jo cilësore, degradimit të shpejtë të sinjalistikës dhe rritjes së rrezikut për aksidente rrugore, çka e bën të domosdoshëm ruajtjen e këtij niveli specifikimesh teknike.

NJËSIA E PROKURIMIT